



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "ASTREA"

Nr.1675 Prot.

Tiranë, më 12.07.2021

Nr.111-21 Regj.

URDHËR

VENDOSJE SEKUESTRO KONSERVATIVE

Drejtuar : Qëndrës Kombëtare të Biznesit ✓

TIRANË

Për dijëni: Debitorit – Shoqëria “Super Foods” Shpk me NIPT M01310010L

Administratorit – Gerald Engjell Lamaj i dtl.03.12.1989

Adresa: Tiranë, Rruga "Siri Kodra", ish Frigoriferi, Kutia Postare nr.149, Njësia Bashkiake nr. 8.
Telefon: 0692040314

Për dijëni: Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Tiranë

Adresa: Tiranë

Për dijëni: **Kreditorit** – Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)

Adresa: Rr. “Stavri Themeli”, 1000, Tiranë.

Unë, Klodjana Çeliku, Përmbarues Gjyqësor pranë Zyrës së Përmbarimit Privat “ASTREA” shpk Nipt: L61306025U, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr.740, datë 23.02.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë *Urdhër*, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.111-21, datë 25.06.2021 kërkesën e kreditorit Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) ndaj debitorit Shoqëria “Super Foods” Shpk me NIPT M01310010L dhe administrator Gerald Engjell Lamaj, në lidhje me Titullin Ekzekutiv Aktin Administrativ “Procesverbal Inspektimi dhe Vendim Përfundimtar” Nr.Serial Nr.AKU-TR-2020-004541-2-5, datë 23.07.2020 dhe Serial Nr.AKU-TR-2020-004195-2-5, datë 14.07.2020.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin Nr.1523 Prot, Datë 28.06.2021, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhëri i Ekzekutimit Nr.740, datë 23.02.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA Se :

Pala debitore Shoqëria “Super Foods” Shpk me NIPT M01310010L dhe administrator Gerald Engjell Lamaj, nuk ka respektuar afatet e neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile.

Në këto kushte, në zbatim të nenit 36 të ligjit Nr.26/2019 miratuar në datë 08.05.2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”,

URDHËROJ:

1. Qendra Kombëtare e Biznesit të vendosë sekuestro konservative mbi aktivet e shoqërisë:
 - **Shoqëria “Super Foods” Shpk me NIPT M01310010L dhe administrator Gerald Engjell Lamaj, deri në një njoftim të dytë të përmbaruesit gjyqësor.**
2. Qendra Kombëtare e Biznesit të na dërgojë një ekstrakt të kësaj shoqërie.
3. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht *brenda afatit ligjor.*
4. Personat që bëhen pengesë, *do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të K.Pr.Civile.*
5. Kundër këtij urdhëri *lejohet ankim* në Gjykatë, brenda *5(pesë) ditëve*, nga dita e marrjes dijeni.

**ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT “ASTREA”
PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT
KLODJANA CELIKU**

